

(<https://top-channel.tv/>)

AKTUALITET ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/VENDI/AKTUALITET/](https://top-channel.tv/artikuj/vendi/aktualitet/))

TË FUNDIT ([HTTPS://TOP-CHANNEL.TV/ARTIKUJ/TE-FUNDIT/](https://top-channel.tv/artikuj/te-fundit/))

Aksion blic në Shkodër, policia arreston dy persona

□ 20/04/2019 14:03



(https://www.facebook.com/app_id=1715618661991455/channel.tv/2019/04/20/aksion-blic-ne-shkoder-policia-arreston-dy-persona/&redirect_uri=https://channel.tv/2019/04/20/aksion-blic-ne-shkoder-policia-arreston-dy-persona/) □

([whatsapp://send?text=https://top-channel.tv/2019/04/20/aksion-blic-ne-shkoder-policia-arreston-dy-persona/](https://www.whatsapp.com/send?text=https://top-channel.tv/2019/04/20/aksion-blic-ne-shkoder-policia-arreston-dy-persona/)) □

(<https://twitter.com/intent/tv?text=Aksion+blic+n%C3%AB-channel.tv/2019/04/20/aksion-blic-ne-shkoder-policia-arreston-dy-persona/>)



Policia e Shkodrës ka bërë një operacion ku arrestoi në flagrancë dy persona për vepra të ndryshme penale. Konkretisht në Shkodër u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit D. H. 30 vjeç, banues në lagjen “Guerrile”, pasi në lagjen “Salo Halili”, gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin tip Audi, iu gjet dhe bllokua në cilësinë e provës materiale, arma e zjarrit pistoletë tip Beretta, me një krehër me 15 fishekë.

Arrestimi për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”. Gjithashtu nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit A. M. 26 vjeç, banues në fshatin Bogë, Malësi e Madhe, pasi në bazë të informacioneve të ardhura nga qytetarët dyshohet se në vendin e quajtur Okol, Malësi e Madhe, ka qëlluar me armë zjarri në ajër, ku grupi hetimor në vendngjarje sekuestroi prova ligjore për dokumentimin e ngjarjes.

26-vjeçari u arrestua për veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të zjarrit dhe municioneve” si dhe “Prishje e rendit e qetësisë publike”. Materialet hetimore ju referuan Prokurorisë Shkodër për veprime të mëtejshme.